



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nenit 17, shkronja h) të Ligjit NR. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASH:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL

KONKURS

**PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE
PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2020/2021**

Nr.	Shkolla	Nr.i paral.	Nr. i nx.	Lëmia dhe profili	Gjithsej
1	Gjimnazi "Sami Frashëri"	10	32	Gjimnaz i shkencave natyrore	320
	<i>Mësimi në gjuhën turke</i>	1	32	Gjimnaz i shkencave natyrore në gjuhën turke	32
	Gjithsej	11	32		352
2	Gjimnazi "Ahmet Gashi"	14	32	Gjimnaz i shkencave shoqërore dhe gjuhësore	448
	Gjithsej	14	32		448
3	Gjimnazi "Matematikor i specializuar"	2	25	Gjimnaz i shkencave matematikore	50
	Gjithsej	2	25		50
4	Gjimnazi "Xhevdet Doda"	12	32	Gjimnaz i shkencave natyrore	384
	Gjithsej	12	32	Gjimnazi i shkencave natyrore	384
5	Gjimnazi "Eqrem Çabej"	8	32	Gjimnazi filologjik	256

	Gjithsej	8	32		256
6	SHMM "Dr.Ali Sokoli"	2	28	Bashkëpunëtor profesional i Infermierisë	56
		2	28	Teknik dentar	56
		2	28	Teknik i Fizioterapisë	56
		2	28	Farmacit	56
	<i>Mësimi në gjuhën boshnjake</i>	1	28	Farmacit	28
	Gjithsej	9	28		252
7	SHMT "28 Nëntori"	1	28	Ndërtimtari e ulët	28
		1	28	Ndërtimtari e lartë	28
		1	28	Teknik i izolimit të ndërtesave	28
		1	28	Ndërtimtar	28
		3	28	Arkitekturë	84
		2	28	Gjeodezi	56
		2	28	PT	56
		1	28	Grafikë shtypi	28
		1	28	Grafikë përgatitja grafike	28
		1	28	Grafikë e libërlidhjes	28
	Gjithsej	14	28		392
8	SHMEJ "Hoxhë K. Prishtina"	3	28	Kontabilitet dhe tatime	84
		2	28	Banka, financadhe Sigurime	56
		2	28	Shpediter dhe logjistikë	56
		2	28	Marketing dhe shitje	56
		4	28	Juridik, administratë dhe shërbime të zyrës	112
		1	28	Asistent i shërbimeve publike	28
	Gjithsej	14	28		392
9	SHMHT "7 Shtatori"	1	28	Ekonomi-tregtar me pakicë dhe shumicë	28
		1	28	Hoteleri-Gjellëbërës	28
		1	28	Shërbime-Asistent i mikpritjes hoteliere	28

		1	28	Shërbime-Asistent i turizmit dhe udhëtimeve	28
	Gjithsej	4	28		112
10	SHMAT "Abdyl Frashëri"	2	28	Bujqësi: Agrobiznes	56
		1	28	Bujqësi: Hortikulturë	28
		1	28	Bujqësi: Mbrojtje e bimëve	28
		1	28	Bujqësi: Kultivues i kulturave të përziera dhe rritës i kafshëve	28
		2	28	Teknologji ushqimore: Përpunues i ushqimeve dhe profesionet e ngjashme	56
		1	28	Veterinë: Veterinari	28
	Gjithsej	8	28		224
11	SHME "Gjin Gazulli"	6	24	Teknik i informatikës	144
		2	24	Teknik i telekomunikacionit	48
		1	24	Instalues elektrik	24
		3	24	Energjetikë	72
	Gjithsej	12	24		288
12	Medreseja e Mesme "Alauddin"	2	32	Djem	64
		2	32	Vajza	64
	Gjithsej	4	32		128
13	SHMM "Prek Jakova"	1	25	Drejtimi i përgjithshëm muzikor	25
		1	25	Interpret muzikor	25
	Gjithsej	2	25		50
	Total	114			3328

Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2020/2021, mund të konkurrojnë vetëm nxënësit të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm të ultë në komunën e Prishtinës (përfundimisht në Gjimnazin e specializuar matematikor dhe në ato drejtime në shkollat profesionale të cilat janë mungesë në komunat tjera), të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e nëntë (IX) jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASH dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Kriteret e detajuara për secilin drejtim i gjeni të publikuara në shkollat përkatëse dhe në web faqen e Komunes së Prishtinës.

Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

Nota mesatare e të gjitha lëndëve (klasat 6-9) (60%) 60 pikë

Nota mesatare nga lëndët prioritare (klasat 6-9) (40%) 40 pikë

Kriteri i lëndëve prioritare nga sukcesi për gjimnaz dhe shkollë mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 e më lartë (Së pari gjendet mesatarja e 4 lëndëve prioritare veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

Gjimnazi i shkencave natyrore

- Lënda I - Fizikë;
- Lënda II - Kimi;
- Lënda III - Biologji;
- Lënda IV - Matematikë.

Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore

- Lënda I - Gjuhë amtare;
- Lënda II - Gjuhë angleze;

- Lënda III - Histori;
- Lënda IV - Gjeografi.

Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

- Lënda I - Fizikë;
- Lënda II – Kimi;
- Lënda III – Biologji;
- Lënda IV - Gjuhë amtare.

Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi — Teknologji

- Lënda I - Fizikë;
- Lënda II - Kimi;
- Lënda IV - Matematikë;
- Lënda V - TIK.

Ekonomi

- Lënda I - Gjuhë amtare;
- Lënda III - Gjeografi;
- Lënda IV - Matematikë;
- Lënda V - TIK.

Juridik, Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

- Lënda I - Gjuhë amtare;
- Lënda II - Gjuhë angleze;
- Lënda III – Histori;
- Lënda IV - Gjeografi.

Shkollat Artistike

Kriteret specifike për regjistrim në shkollën e muzikës:

Drejtimi pedagogjik: profili bashkëpunëtor muzikor;

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. 9);

Drejtimi instrumental: nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. 9) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl. 1-6 ose 1-8 varësisht nga instrumenti);

Të gjithë nxënësit do të regjistrohen në klasën e 10 — duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6-9) mund t'i fitojë maksimalisht 60 pikë. Formula për Llogaritjen e pikëve të suksesit është: (mes.kl.6 + mes.kl. 7 + mes.kl.8 + mes.kl.9) x3 = 60 pikë max.

Nxënësi nga suksesi në lëndët prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 40 pikë, shuma e mesatares së 4 lëndëve shumëzohet me 2.

(mes. lënda (I) + mes. lënda (II) + mes. Lënda(III) + mes. Lënda (IV)x2=40pikë Max.

Në rast se nuk mund të bëhet pranimi ngase kandidatët kanë pikë të barabarta do të merren parasysh edhe këto kritere shtesë.

Suksesi në klasat 1-5 mblidhet nota mesatare e 5 viteve dhe pjesëtohet me 5 pikë.

Pjesëmarrja në gara ndërkombëtare të diturisë.....5 pikë

Vendi i parë në gara shtetërore të diturisë.....5 pikë

Vendi i dytë në gara shtetërore të diturisë.....4 pikë

Vendi i tretë në gara shtetërore të diturisë.....3 pikë

Vendi i parë në gara komunale të diturisë.....3. pikë

Vendi i dytë në gara komunale të diturisë.....2 pikë

Vendi i tretë në gara komunale të diturisë.....1 pikë

Nëse shkolla edhe me këto kritere shtesë nuk mund të bëj përzgjedhjen e kandidatëve me pikë të barabartë, atëherë shkolla për këta kandidatë organizon vlerësim apo testim.

GJIMNAZI I SPECIALIZUAR MATEMATIKOR NË PRISHTINË

Kushtet dhe kriteret për Regjistrim në Gjimnazin e Specializuar Matematikor në Prishtinë

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt në Gjimnazin e Specializuar Matematikor

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e **10-të**, në Gjimnazin e Specializuar Matematikor, për vitin shkollor **2020/21**, mund të konkurrojnë vetëm nxënësit e shkëlqyeshëm, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se **17 vjeç**.

Kandidatët që konkurrojnë kanë të drejtë të jenë nga të gjitha komunat e Kosovës, të cilët konsiderojnë se kanë prirje për Matematikë.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në këtë Gjimnaz, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollë)
- Dëftesën e fotokopjuar për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Ekstraktin e lindjes.

3. Kriteret për regjistrim

Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë – duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

- Kandidatët kanë të drejtë të jenë nga të gjitha komunat e Kosovës, të cilët konsiderojnë se kanë prirje për Matematikë.
- Kandidatë do t'i nënshtrohen Provimit Pranues.
- Provimi pranues përgatitet, kontrollohet nga mësimdhënës të Autorizuar nga Bordi.
- Kandidatët mund të mos i tërheqin dokumentet nga shkollat ku janë pranuar. Mjafton të sjellin dëshmitë e fotokopjuara.

- Për rangimin final të kandidatëve merren parasysh:
 - Suksesi i Përgjithshëm nga Shkolla e mesme e ulët (20%);
 - Suksesi nga Lënda e Matematikës në Shkollën e mesme të ulët (20%);
 - Suksesi i Provimit Pranues (60%).

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për Gjimnazin e Specializuar Matematikor, për vitin shkollor **2020/21**, bëhet prej datës **17-21 gusht 2020** në lokalet e shkollës amë, duke filluar nga ora **9.00-16.00**.
Provimi pranues me datën **24 gusht 2020 në ora 10.00**.

Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurren)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2020/2021, bëhet më datën **17-21.08.2020** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **08:00-16:00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **24.08.2020 (në shkollat ku plotësohet numri)**.

28.08.2020 (në shkollat ku nuk plotësohet numri i nxënësve dhe vazhdon konkurrimi).

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës: **24-31.08.2020**.

AFATI I ANKESAVE

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, **brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës.**

Vërejtje: Mosparaqitja e ankesës në afatin zyrtar, në shkollën përkatëse, nënkupton humbje e të drejtës për ankesë në shkollën e dytë në Drejtorinë e Arsimit (DKA) apo në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH). DKA dhe MASH nuk shqyrton asnjë ankesë nëse ajo paraprakisht nuk është shqyrtuar nga komisioni përkatës i shkollës.